
 <p>DA V Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Rregullore e Komiteteve Teknike	<i>Kodi DA-RG-003</i>
		<i>Rishikim nr 0</i> Dt ____/____/____
		<i>Faqe 1 nga 4</i>

RREGULLORE E KOMITETEVE TEKNIKE

Zbatues: Anëtarët e komiteteve teknike, Drejtoria e Dkreditimit

Përgjegjës për zbatimin: Drejtori i Përgjithshëm

	Hartoi	Kontrolloi	Miratoi	Data e miratimit
Botimi I	Ardita Fuga	Ardita Fuga Besnik Pani	Agim Anxhaku	
Rishikimi 01				

 <p>Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<h2>Rregullore e Komiteteve Teknike</h2>	<p>Kodi DA-RG-003</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt ____/____/____</p> <hr/> <p>Faqe 2 nga 4</p>
---	--	---

1. Parimet e përgjithshme

1.1 Komitetet teknike për akreditimin janë krijuar sipas ISO 17011 “Kërkesa të përgjithshme për organizmat akreditues që akreditojnë organizma të vlerësimit të konformitetit”, paragrafi 4.2.7.

1.2 Komitetet teknike miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

1.3 Komitetet teknike krijohen brenda organizimit dhe strukturës së DA me detyra të përcaktuara sipas pikës 3.

1.4 DA sipas fushave ku ofron shërbimin e akreditimit krijon tre komitete teknike që janë si më poshtë:


- ↳ Komiteti teknik i laboratorëve
- ↳ Komiteti teknik i certifikimit
- ↳ Komiteti teknik i inspektimit

1.5 Numri i anëtarëve të komitetit nuk është i kufizuar por nuk duhet të ketë mbizotërim të njëjës palë.

2. Anëtarët e komiteteve teknike

2.1 Anëtarët e komiteteve teknike duhet të jenë ekspert të fushës përkatëse më një kualifikim dhe eksperiencë pune të provuar.

2.2 Anëtarët e komiteteve teknike janë përfaqësues të institucioneve kërkimore shkencore, institucioneve të administratës shtetërore, të firmave private vendase apo të huaja apo edhe individë të cilët kanë njohuri të përgjithshme në lidhje me akreditimin dhe vecanërisht për fushën në fjalë.

 <p>da Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p>Rregullore e Komiteteve Teknike</p>	<p>Kodi DA-RG-003</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt ____/____/____</p> <hr/> <p>Faqe 3 nga 4</p>
---	---	--

2.3 Anëtarët e komiteteve teknike duhet të jenë të paanëshëm dhe të pavarur. Ata nuk duhet të kenë konflikt interesash dhe nuk duhet të ndikojnë në mos respektimin e parimeve të akreditimit.

2.4 Anëtarët e komiteteve teknike miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm

2.5 Anëtarët zgjedhin një kryetar dhe një nënkryetar të komitetit, me shumicë votash, të cilët kanë mandate një vjeçar. Ata kanë të drejtë rizgjedhjeje por jo më shumë se dy herë radhazi..

2.6 Një punonjës i DA i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm do të luaj rolin e sekretarit të komitetit.

2.7 Anëtarët e komiteteve janë të detyruar të ruajnë konfidencial të gjithë informacionin në lidhje me procedurat e akreditimit.

2.8 Punonjës të DA mund të jenë anëtarë të Komiteteve të vecanta sipas fushës së specialitetit të tyre.

3. Detyrat e komiteteve teknike :

3.1 Komitetet teknik kanë rol konsultativ në lidhje me çështje teknike që kanë të bëjnë më marrjen e vendimit të akreditimit.

3.2 Hartojnë rregulla dhe pyetësor të specializuar për fusha të vecanta të akreditimit.


3.3 Marrin pjesë në hartimin e procedurave teknike për procesin e akreditimit sidomos për rastë shumë specifike ku ekspertiza brenda DA mungon.

3.4 Përcaktojnë kërkesa të specializuara për vlerësuesit në fusha të vecanta.

3.5 Marrin pjesë në trajnimet që DA organizon për rritjen e kualifikimit të vlerësuesve të saj.

3.6 Mbështet DA në lidhje me interpretimin e rezultateve të pjesëmarrjes në krahasimet ndërlaboratorike apo testet e zotësisë.

3.7 Mbështet krijimin e regjistrit të vlerësuesve të DA

 <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	Rregullore e Komiteteve Teknike	<p>Kodi DA-RG-003</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt ____/____/____</p> <hr/> <p>Faqe 4 nga 4</p>
--	--	--

3.8 Shkëmben eksperiencën midis vlerësuesve

3.9 Ndhmon në mbajtjen e një bashkëpunimi të mirë midis organizmit akreditues dhe organizmave të akredituar.

3.10 Diskuton draftet e dokumentave të EA dhe ILAC

4. Funksionimi

4.1 Komitetet teknike mblidhen me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm, me kërkesë të kryetarit të komitetit osë më kërkesë të të paktën tre anëtarëve.

4.2 Agjenda e takimit shpërndahe të paktën pesë ditë punë më parë së takimi.

4.3 Takimet zhvillohen gjithmonë praën zyrave të DA, gjatë orarit të punës.

4.4 Mbledhja e komiteteve teknike mbahet vetëm kur janë më shumë se gjysma e anëtarëve sidomos kur në takim do të merren vendime.

4.5 Në raste të vecanta në këto komitete thirren edhe punonjës të DA sidomos kur diskutohen çështje të hartimit të procedurave të akreditimit..

4.6 Kryetari i komitetit është i detyruar të drejtojë mbledhjen dhe në mungesë të tij e drejton nënkryetari. Nënkyetari merr të gjithë autoritetin e kryetarit në rast mungese të këtij të fundit.

4.8 Protokollet e mbledhjeve mbahen nga sekretari dhe në fund të mbledhjes firmosen nga të gjithë të pranishmit. Këto protokolle brenda 2 javësh i bëhen me dije edhe Drejtorit të Përgjithshëm të DA. Vendimet i transmetohen Drejtorit nga kryetari i Komitetit.

4.9 Vendimet merren me shumicë të thjeshtë.

4.10 Informacioni i diskutuar në mbledhje është konfidencial. Cdo anëtar i komitetit teknik nënshkruan Deklaratën e Konfidencialitetit DA-FO-010.

4.11 Për raste të vecanta, kur shikohet e arsyeshme nga kryetari mund të krijohen edhe nëngrupe pune të cilat funksionojnë mbi bazën e kësaj rregulloreje dhe termave të referencës të hartuara për cdo nëngrup.

